



Në bazë të nenit 45 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017, për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-0127980/18 dt. 29.06.2018, të investitorit Kamer Çitaku nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, të ndërrimit të destinimit të përdorimit të hapësirës banesore në hapësirë afariste, në lagjen “Dardania”, rr. “Besëlidhja”, nr. 34 në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative me datë 23.10.2018, lëshon këtë:

### **CERTIFIKATË E PËRDORIMIT**

#### **Ndërrimi i destinimit të përdorimit të hapësirës banesore në hapësirë afariste**

**I. I LEJOHET** investitorit Kamer Çitaku nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-0127980/18 dt. 29.06.2018, përdorimi i lokalit afarist, në kuader të ndërtesës shumëbanesore, në lagjen “Dardania”, rr. “28 Nëntori”, “Besëlidhja”, nr. 34 në Prishtinë, evidentuar në certifikatën e njësise kadastrale O-71914059-07576-1-363-14-0 ZK Prishtinë.

**II.** Lokali afarist, për të cilin është bërë ndërrim destinimi, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-0242437/17 dt. 20.11.2017, dokumentacionit ndërtimor dhe Raportit të Inspektimit final, 09 Nr. 354/02-0012764/18 dt. 16.01.2018, të Drejtorisë së Inseksionit të Komunës së Prishtinës, mund të përdoret/shfrytëzohet nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate.

**III.** Kjo certifikatë do të shërbejë edhe për regjistrimin e lokalit afariste në regjistrin kadastral.

### **A r s y e t i m**

Drejtoria e Inspeksionit-Spektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresës “Akt përcjellës” 05 Nr. 391/02-0127980/18 dt. 28.06.2018, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit “Raportin Final” 09 Nr. 354/02-0012764/18 dt. 16.01.2018, përpiluar nga komisioni për shqyrtimin e kërkesave të inspektimit final të kësaj drejtorie.

Drejtoria e Urbanizmit pas shqyrtimit të shkresës me raportin e lartcekur, dosjen e lëndes 05 Nr. 391/02-0127980/18 dt. 28.06.2018, me shkresën “Plotësim Dokumentacioni” 05 Nr. 391/02-0127980/18 dt. 28.06.2018, ka kërkuar nga investitori që të bëjë plotësimin e kërkesës bazë, gjegjësisht ka kërkuar të prezantohet dokumentacioni teknik sipas shtojcës numër 6 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017, për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, të cilin dokumentacion investitori është obliguar ta prezantoj brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh.

Drejtoria e Urbanizmit, pas pranimit të plotësimit të kërkuar përmes shkresës “Plotësim dokumentacioni” 05 Nr. 391/02-0127980/18 dt. 17.10.2018, ka konstatuar se investitori ka prezantuar:

- Raportin e Inspektimit Final, 09 Nr. 354/02-0012764/18 dt. 16.01.2018, të lokalit afariste, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës;
- Inspektimin Final të dt. 22.05.2018, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit;
- Incizimin gjeodezik, punuar nga gjeodeti i licencuar Xhavit Fetahu nga Korretica e Poshtme, Glllogoc, me nr. të licencës 75;
- Fotografi gjatë procesit të ndërtimit;
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve, certifikatat;
- Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi i.d.a. Selim Krsniqi, me dt. 07.04.2018;
- Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi i.d.n. Bekim Rexhepi, me dt. 07.04.2018;
- Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellsit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi i.d.h. Rifat Krasniqi, me dt. 07.04.2018;
- Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi i.d.e. Enver Krasniqi, me dt. 07.04.2018;
- Kopjet e diplomave të inxhinierëve;
- Dëshmin mbi pagesen e lejes ndërtimore, fatura nr. 000470 të dt. 17.11.2017.

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, 09 Nr. 354/02-0012764/18 dt. 16.01.2018, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht lokali afarist mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017, për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent leshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori vendosi që lokali afarist, mund të përdoret, gjegjësisht të lëshojë certifikatën e përdorimit për lokalin afarist.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certifikate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie renda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certifikate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

**I dorëzohet:** Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**05 NR. 391/02-0127980/18 DT. 23.10.2018**

Zyrtarja,  
 Bahtije Vllasaliu

*B. Vllasaliu*

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,  
 Mimoza Berisha Prestreshi

*M. Berisha*

